Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

# PLANI VJETOR I PUNËS 2021

Tiranë, Janar 2021

# PLANI VJETOR 2021
# DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBIKËQYRJES DHE INSPEKTIMIT

| Nr. | Subjekti i mbikëqyrjes | Arsyeja e mbikëqyrjes/inspektimit | Drejtoria përgjegjëse | Koha e mbikëqyrjes/inspektimit e ndarë në 3-mujorë | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | I | II | III | IV |
| **A.** | **Mbikëqyrje/inspektim i orientuar në mbledhjen e informacionit** | | | | | | |
| 1. | Në këtë proces do të përfshihen të gjitha procedurat e rekrutimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë në institucionet që punësojnë nëpunës civilë, në administratën shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.<br>• Departamenti i Administratës Publike.<br>• Njësitë përgjegjëse në Njësitë e Qeverisjes Vendore<br>• Institucionet e Pavarura | Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është institucioni që siguron zbatimin e parimeve të ligjit për nëpunësin civil gjatë procesit të plotësimit të pozicioneve të punës nëpërmjet procedurave të pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, që janë parimi i shanseve të barabarta, emërimi në bazë të meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit, nëpërmjet një procesi përzgjedhës dhe transparent.<br><br>Në këto rrethana, vlerësuar rëndësinë e këtij procesi, Komisioneri e ka përcaktuar si prioritet ndjekjen e tij nëpërmjet inspektorëve të ngarkuar për ta mbikëqyrur zhvillimin e tij përgjatë gjithë vitit kalendarik, sipas një metodologjie të përcaktuar në rregulloren e institucionit, në të gjitha subjektet që punësojnë nëpunës civilë..<br><br>Problematikat që do të evidentohen gjatë këtij procesi do të shërbejnë për të ndërhyrë më tej për të rregulluar paligjshmëritë e konstatuara. | Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit | Po | Po | Po | Po |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2. | • Institucionet e Administratës Shtetërore<br>• Institucionet e Qeverisjes Vendore<br>• Institucionet e Pavarura | Në kuadër të zhvillimit të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke patur parasysh problematikën e evidentur gjatë procesit të monitorimit të sjelljes së nëpunësit civil në proceset zgjdhore të mëparshme do të monitorojë këtë proces tek të gjitha institucionet që janë pjesë e shërbimit civil. | Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit | Po | Po | | |
| 3. | • Institucionet e Administratës Shtetërore<br>• Njësitë e Qeverisjes Vendore<br>• Institucionet e Pavarura | Në kuadër të zbatimit të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2019, e cila e ka caktuar si detyrë të përhershme këtë aspekt, si dhe Urdhërit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, do të vijojë edhe për vitin 2021, monitorimi i zbatimit të ligjshmërisë në drejtim të respektimit të procedurave për lirimin nga shërbimi civil të nëpunësve të cilët kanë mbushur moshën e pensionit të plotë të pleqërisë.<br>Do të vazhdojë komunikimi me njësitë përgjegjëse të institucioneve të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit të shërbimit civil gjatë gjithë vitit, me qëllimin përmbushjen e ligjshmërisë në këtë drejtim. | Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit | Po | Po | Po | Po |
| **B.** | **Mbikëqyrje të Përgjithshme** | | | | | | |
| **Njësitë e Qeverisjes Vendore** | | | | | | | |
| 1 | **Bashkia Elbasan** | Përfshirja e subjektit në mbikëqyrje të përgjithshme duke qenë se ky institucion i qeverisjes vendore ka kaluar në proces ristrukturimi të thellë, duke aplikuar të gjitha institutet e ligjit nr. 152/2013, ”*Për nëpunësin civil*” , i ndryshuar.<br>Për këtë arsye, lind nevoja të mbikëqyret zbatimi i ligjit në të gjitha aspektet e tij. | Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit | | Po | Po | Po |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | **Bashkia Shkodër** | Përfshirja e subjektit në mbikëqyrje të përgjithshme, duke qenë se ky institucion i qeverisjes vendore ka kaluar në proces të thellë ristrukturimi, duke aplikuar të gjitha institutet e ligjit nr. 152/2013, ”*Për nëpunësin civil*” , i ndryshuar.<br>Për këtë arsye, lind nevoja të mbikëqyret zbatimi i ligjit në të gjitha aspektet e tij. | Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit | | Po | Po | Po |
| 3 | **Bashkia Berat** | Përfshirja e subjektit në mbikëqyrje të përgjithshme duke qenë se ky institucion i qeverisjes vendore ka kaluar në proces të thellë ristrukturimi dhe për këtë arsye duhet të kontrollohet zbatimi i ligjit në të gjitha aspektet e tij. | Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit | | Po | Po | Po |
| 4 | **Bashkia Këlcyrë** | Përfshirja e subjektit në mbikëqyrje të përgjithshme duke qenë se ky institucion i qeverisjes vendore ka shfaqur problematika të theksuara në drejtim të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil në të gjitha aspektet e tij. Ky subjekt ka nevojë për asistencë të menjëhershme në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të ligjit. | Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit | | Po | Po | Po |
| 5. | **Bashkia Mallakastër** | Përfshirja e subjektit në mbikëqyrje të përgjithshme duke qenë se ky institucion i qeverisjes vendore ka shfaqur problematika të theksuara në drejtim të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil në të gjitha aspektet e tij. Ky subjekt ka nevojë për asistencë të menjëhershme në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të ligjit. | Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit | | Po | Po | Po |
| **Institucione të Administratës Shtetërore** | | | | | | | |
| | | Ky proces synon të shtrihet në veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse në lidhje me proceset e administrimit të shërbimit civil për të gjitha institutet e ligjit nr. 152/2013, ”*Për nëpunësin civil*” , i ndryshuar, e në vijim. | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Institucionet e varësisë; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë** | Mbikëqyrja në këtë institucion është planifikuar në kuadër të mbikëqyrjes së përgjithshme në vazhdim të vitit të kaluar për institucionet e varësisë së kësaj ministrie. Ky proces synon të shtrihet në veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse në lidhje me proceset e administrimit të shërbimit civil, të kryera prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, ”*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, e në vijim. | Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit | | Po | Po | Po |
| 2 | **Institucionet e varësisë; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** | Mbikëqyrja në këtë institucion është planifikuar në kuadër të mbikëqyrjes së përgjithshme në vazhdim të vitit të kaluar për institucionet e varësisë së kësaj ministrie. Ky proces synon të shtrihet në veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse në lidhje me proceset e administrimit të shërbimit civil, të kryera prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, ”*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, e në vijim. | Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit | | Po | Po | Po |
| 3 | **Institucionet e varësisë; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** | Mbikëqyrja në këtë institucion është planifikuar në kuadër të mbikëqyrjes së përgjithshme në vazhdim të vitit të kaluar për institucionet e varësisë së kësaj ministrie. Ky proces synon të shtrihet në veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse në lidhje me proceset e administrimit të shërbimit civil, të kryera prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, ”*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, e në vijim. | Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit | | Po | Po | Po |
| **INSTITUCIONE TË PAVARURA** | | | | | | | |
| 1. | **Inspektori i Lartë i Drejtësisë** | Përfshirja e subjektit në mbikëqyrje të përgjithshme është planifikuar sipas kërkesës së institucionit dhe njëkohësisht mbi bazën e riskut, për shkak se është një institucion i ri që vepron në fushën e shërbimit civil. | Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit | | Po | Po | Po |
| | | | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2. | **INSTAT** | Mbikëqyrja në këtë institucion është planifikuar në kuadër të mbikëqyrjes së përgjithshme duke qenë se ka ndryshuar edhe mënyra edhe forma e organizmit të këtij institucioni. Ky proces synon të shtrihet në veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse në lidhje me proceset e administrimit të shërbimit civil sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, ”*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. | Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit | | Po | Po | Po |
| **C.** | **MBIKËQYRJE TEMATIKE** | | | | | | |
| - Në kuadër të zbatimit të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2019, e cila e ka lënë si një detyrë të përhershme të Komisionerit këtë aspekt të zbatimit të ligjit, si dhe të Urdhërit të Komisionerit, lidhur me monitorimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, do të vazhdojë puna tashmë në ekzekutimin konkret të vendimeve individuale për nëpunësit civil të evidentuar deri më tani.<br>- Gjithashtu do të përfshihen në këtë process edhe institucionet e pavaruara me qëllim verifikimin e zbatimit të procedurave ligjore nga ana e njësisë përgjegjëse, sipas ligjit nr. 152/2013, ”*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. | | | | | | | |
| 1 | **Institucionet e Administratës Shtetërore dhe institucionet e varësisë (Kryeministria, Ministritë e Linjës dhe institucionet e varësisë)** | Pas evidentimit të nëpunësve civilë gjyqfitues, do të vazhdojë puna me institucionet e administratës shtetërore, njësinë përgjegjëse, njësitë e burimeve njerëzore, si dhe me nëpunësit civilë që kanë vendim të formës së prerë, tashmë duke evidentuar pozicionet konkrete, të cilat përputhen me pozicionet që mbanin këta nëpunës para largimit nga detyra, duke kërkuar më pas lidhjen e marrëdhënieve të punës mes tyre dhe institucionit. | Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit | Po | Po | Po | Po |
| 2 | **Institucionet e Pavarura (Institucionet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj të veçantë)** | Pas evidentimit të nëpunësve civilë gjyqfitues, do të vazhdojë puna me institucionet e pavarura dhe me nëpunësit civilë që kanë vendim të formës së prerë, tashmë duke evidentuar pozicionet konkrete, të cilat përputhen me pozicionet që mbanin këta nëpunës para largimit nga detyra, duke kërkuar më pas lidhjen e marrëdhënieve të punës mes tyre dhe institucionit. | Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit | Po | Po | Po | Po |
| 3 | **Institucionet e Qeverisjes vendore (Bashkitë)** | Pas evidentimit të nëpunësve civilë gjyqfitues, do të vazhdojë puna me institucionet e qeverisjes vendore dhe me nëpunësit civilë që kanë vendim të formës së prerë, tashmë duke | Drejtoria e Përgjithshme e | Po | Po | Po | Po |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | evidentuar pozicionet konkrete, të cilat përputhen me pozicionet që mbanin këta nëpunës para largimit nga detyra, duke kërkuar më pas lidhjen e marrëdhënieve të punës mes tyre dhe institucionit. | Mbikëqyrjes dhe Inspektimit | | | | |
| **D.** | **Mbikëqyrje në vazhdim në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Komisionerit** | | | | | | |
| **E** | **Verifikimi i informacioneve të ardhura në adresë të Komisionerit dhe zgjidhja e rasteve individuale** | | | | | | |
| | Institucione të Administratës Shtetërore, Njësi të Qeverisjes Vendore dhe Institucione të pavarura | Në këtë proces do të përfshihet verifikimi i informacioneve që vijnë nga burime të ndryshme dhe zgjidhja e rasteve individuale që kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme të Komisionerit, me qëllim që institucioni t`i përgjigjet në kohë reale dinamikës së lartë të zhvillimeve në administratën publike. | Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit | Po | Po | Po | Po |

# PLANI VJETOR 2021
# DREJTORIA E ÇËSHTJEVE LIGJORE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

| **Aktiviteti** | **Afati** |
|---|---|
| **I. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të Komisionerit** | |
| Në këtë proces do të përfshihen:<br>- vendimet paralajmëruese të Komisionerit të nxjerra gjatë vitit 2020 dhe për të cilat afati i lënë në vendim përfundon në vitin 2021;<br>- vendimet paralajmëruese që do të dalin gjatë vitit 2021 pas përfundimit të afatit për zbatimin e tyre. | Janar – Dhjetor 2021 |
| **II. Përfshirje në mbikëqyrje/inspektim** | |
| Përfshirje në grupet e punës së mbikëqyrjes/inspektimit. | Janar – Dhjetor 2021 |
| **III. Ndjekja e procesit në lidhje me personat që kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë dhe vazhdojnë të jenë në marrëdhënie pune** | |
| Ky proces do të shtrihet në të gjitha institucionet që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit Nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar. | Janar – Dhjetor 2021 |
| **IV. Përfaqësim në proceset gjyqësore administrative, në të gjitha shkallët e gjykimit** | |
| | |

| | |
|---|---|
| Përfaqësim i institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil gjatë të gjitha proceseve gjyqësore administrative, në të gjitha shkallët e gjykimit, duke ndjekur rregullisht çdo seancë gjyqësore. | Janar – Dhjetor 2021 |
| **V. Bashkëpunimi me institucionet apo organizmat e huaj, brenda & jashtë vendit përgjatë vitit 2021** | |

# PLANI VJETOR 2021
# DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

| OBJEKTIVI | MASAT E PËRGJITHSHME | PERIUDHA | REZULTATI |
|---|---|---|---|
| Hartimi i Raportit Vjetor 2020 mbi veprimtarinë e Komisionerit për fushën e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. | Hartimi i draft - raportit;<br><br>Koordinim brenda drejtorisë me qëllim mbledhjen e informacioneve/statistikave në lidhje me performancën dhe treguesit tekniko-ekonomikë vjetorë. | Janar-Shkurt | Raporti Vjetor 2020 i hartuar dhe përcjellje tek Drejtori i Përgjithshëm/ DÇJ & MJ; |
| Funksionimi normal i strukturës së KMSHC-së. | Publikimi i planit të pranimit në shërbimin civil për 2021;<br><br>Ndjekja e procesit të rekrutimit në përputhje me ligjin nr.152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar;<br><br>Vlerësimi periodik i punonjësve (me status të punonjësit civil /ose në kohë prove, si dhe mbledhja dhe përpunimi i rezultateve për hartimin e raportit;<br><br>Vlerësime individuale, konfirmim i nëpunësve dhe procedura disiplinore sipas rastit;<br><br>Hartimi i raportit vjetor të punës së Autoritetit Përgjegjës dhe problematikave të institucionit. | Janar – Shkurt<br><br>Çdo 6-mujor<br><br>Gjatë vitit | Strukturë e konsoliduar (31 punonjës);<br><br>4 punonjës të përkohshëm me kohë pune të reduktuar (6 orë/dita).<br><br>Punonjës të vlerësuar |
| Transparencë e vazhdueshme e zyrtarëve që mbartin detyrimin për | Asistencë në procesin e plotësimit dhe dërgimit të deklaratave të pasurisë të zyrtarëve që mbartin detyrimin për | Mars-Prill | Strukturë e konsoliduar. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| deklarimin e pasurisë<br><br><br><br><br><br>Marrëdhëniet me publikun | deklarimin e pasurisë.<br>Kontakte të vazhdueshme me institucionin e ILDKPKI-së në kuadër të bashkëpunimit reciprok të vendosur.<br><br>Informim i publikut, ofrimi i shërbimeve publike për qytetarët rreth misionit, funksionit dhe qëllimit për të cilin është krijuar Komisioneri. | Janar-Prill<br><br><br>Gjatë vitit | Raport vjetor i dorëzuar.<br><br>Deklarata të dorëzuara.<br><br><br>Publik i informuar |
| Përmirësim i Kontrollit dhe Menaxhimit Financiar. | Koordinimi me çdo strukturë, për monitorimin në vazhdimësi të procesit të Menaxhimit Financiar;<br><br>Marrja e masave në zbutjen e nivelit të rreziqeve gjatë veprimtarisë së strukturave;<br><br>Marrja e masave në kohë për përballimin me sukses të situatës së pandemisë Covid-19;<br><br>Miratimi i kalendarit të Dokumentit të PBA-së;<br><br>Hartimi i PBA-së për vitet 2022-2024;<br>Evidentimi dhe reflektimi i kërkesave shtesë në fazën strategjike, gjatë nogociimit dhe mbrojtjes së buxhetit, për sigurimin e buxhetit real të vitit buxhetor;<br><br>Përdorimi i buxhetit mbi baza produkti;<br>Analizë e kosto-përfitimit për çdo aktivitet;<br><br>Mbikëqyrja dhe monitorimi i procedurave të prokurimit në mbështetje të realizimit me | Janar-Shkurt<br><br><br>Gjatë vitit<br><br>Mars-Prill<br><br>Prill-Shtator<br><br>Gjatë vitit<br><br>Gjatë vitit<br><br><br>Gjatë vitit | Sistem efektiv menaxhimi.<br>Pyetësor i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të dorëzuar.<br><br>Sistem efektiv menaxhimi.<br><br><br><br>Buxhet i siguruar dhe i realizuar sipas prioriteteve.<br><br><br><br>Raporte monitorimi të dorëzuara. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | sukses të planit të buxhetit si dhe në mbështetje të fuqizimit të kapaciteteve logjistike prioritare;<br><br>Efiçensë dhe transparencë gjatë ekzekutimit të buxhetit, nëpërmjet organizimit të takimeve periodike të GMS (Grupi i Menaxhimit Strategjik) dhe dhënies së informacioneve në kohë për vendimmarrje;<br><br>Raportim i shpenzimeve buxhetore të kryera të vitit ushtrimor;<br><br>Evidentim i risqeve dhe marrja e masave konkrete për reduktimin e tyre, në funksion të sigurimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit 2021. | Gjatë vitit<br><br>Gjatë vitit | Raporte realizimi të procedurave të prokurimit<br><br>Procesverbale dhe Raportime periodike<br><br>Raportime periodike<br><br>Raportime sipas rastit |
| Kualifikim i thelluar i burimeve njerëzore të KMSHC-së. | Hartim i planit të trajnimeve për zhvillimin e njohurive shtesë, me burime të brendshme dhe të jashtme;<br><br>Pjesëmarrje aktive në trajnimet e ofruara nga ASPA dhe/ose organizata publike jopublike apo të huaja. | Gjatë vitit | Staf i trajnuar në nivel profesional/statistika. |
| Investime në Pajisje dhe Mobilje zyre | Ndjekja e procedurave të prokurimit të shpenzimeve kapitale (investimet), për krijimin e kushteve optimale të punës;<br>Pajisje me mjete kompjuterike dhe elektronike;<br>Analizë e risqeve të funksionimit të brendshëm të sistemeve të instaluara, në funksion të mirëadministrimit të | Gjatë vitit | Ambjente me standarde për çdo post pune.<br><br>Raportime periodike. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | infrastruktures. | | |
| Rikonceptim, transparencë, zhvillim dhe monitorim i faqes zyrtare.<br><br>Digjitalizim i arkivës së institucionit | Rikonceptim dhe përditësimi i faqes zyrtare të institucionit;<br><br>Raportime mujore nga çdo drejtori për materialet e përpunuara për publikim;<br><br>Përpunim i dokumenteve ekzistuese dhe përgatitja e tyre për t'i dorëzuar në institucionin e Arkivit Qendror Shtetëror. | Gjatë vitit<br><br>Gjatë vitit | Faqe zyrtare e përditësuar.<br><br>Dokumentacion i dorëzuar. |